



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 12

Datë: 22. 02. 2020. Ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtişi, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.09/2020

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës buxhetore për kompensim për orët shtesë për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së;

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.09/2020

Valdete Daka: E keni rendin e ditës, a ka vërejtje..?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.09/2020

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalit të mbledhjes nr.09/2020, me një vërejtje teknike.

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës buxhetore për kompensim për orët shtesë për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së:

Sami Hamiti: E kemi mbajtur mbledhjen, dhe kemi dhënë sugjerimet për KQZ lidhur me planin e buxhetit për kompenzimin e anëtarëve të stafit të KQZ-së për punën jashtë orarit. Dje kemi marrë nga Sekretariati një përllogaritje në bazë të vendimeve që janë marrë nga KQZ për zgjatje të orarit: për Sekretariatit në bazë të Ligjit për Shërbyesit Civilë, dhe për anëtarët e KQZ-së në bazë të Ligjit të Punës.

Me konkonzus të plotë, në konsultim edhe me kryetaren, për të dy palët kemi ardhë në përfundim që pagesa shtesë të bëhet për 40 orë. Pra, edhe Sekretariati, edhe KQZ.

Z. Hamiti, shpjegoi rrjedhën e një rekomandimi të këtillë, duke kërkuar nga Sekretariati që përllogaritje për punën shtesë, të bëhet mbi konditat e 40 orëve shtesë.

Alim Rama: Normalisht, cdo punë jashtë urarit të kompenzohet në bazë të ligjit, sugjerimi im është, ka qenë edhe në këshill, që Sekretariati me e argumentue në detale: cilat janë orët shtesë, aktivitetet, se kjo nuk është një punë blanko. Jo secila njësi e Sekretariatit ka me punue në të njetën kohë! Sekretariati, me specifiku cilat njësi, edhe me arsytu punët që Sekretariati punon jashtë orarit të rregullut...

Sami Kurteshi: Ministri ka thënë: “Ata leti bëjnë si të donë kompenzimet e tyre brenda institucionit po, nuk ka me pasë paga shtesë për punë jashtë orarit...”, dhe ky mendoj unë, ka me qenë problemi! E kisha lutë edhe Sekretariatit dhe KQZ-së që, mos me u fokusuar vetëm në kompenzimin

financiar, sepse është mundësia e marrjes së pushimit. Pra, të evitohet konflikti me qeverinë për mjete financiare. Le të reduktohet ajo që nuk është e mundur, dhe të zbatohet ajo që është e mundur...Ta evitojmë konfliktin, dhe mirë do të ishte që të mos fokusohemi vetëm në aspektin material...

Valdete Daka: Nuk është që KQZ, është fokusuar vetëm në aspektin material, nuk është ky qëllimi, pikësynimi as i punëtorëve as i anëtarëve të KQZ. Është një fakt se punëtorët që punojnë në ditën e zgjedhjeve, pastaj çështja e trajnimeve që për shkak të nxënësve duhet punuar të shtunën dhe të dielën për trajnime, për shembull, të shtunën, një ditë para zgjedhjeve shpërndahet materiale dhe duhet të punohet...! Pra, çdo punëtorë nesër mundet me paraqitë padi në gjykatë, dhe secili e fiton gjyqin sepse, kjo është me ligj. Secili, madje me kamatë, e fiton përmes padisë civile. Ne, nuk po duam konfrontim me qeverinë, sepse prej ditës së parë punëtorët i kanë realizuar orët shtesë...

Këtu, tha znj. Daka, nuk është se dikush po do me u konfrontue me Qeverinë...Por janë të drejta që, punëtorëve u takojnë me ligj.

Eshref Vishi: Jemi bërë target medial dhe target i qytetarëve, gjoja se ne po kërkojmë ngritje të pagave. Unë, po ndihem keq dhe besoj edhe ju ndiheni keq që u hap ky konflikt me Ministrinë e Financave. Unë po shpresoj që ky specifikacion i shpenzimeve në bazë të një sinteze të stafit për orë shtesë, është elaborue nga Sekretariati dhe, është rekomandua edhe nga këshilli për buxhet në KQZ. Tejkalimi i 40 orëve shtesë, ka me qenë evident, duke u bazuar edhe nga praktikat e organizimit të zgjedhjeve të deritanishme. Por, ne po pajtohemi që kjo të jetë brenda ligjore. Ka angazhim brenda stafit më shumë se 40 orëve, pavarësisht se nuk kanë ngarkesa të gjithë në të njëjtën kohë. Po shpresoj që, ndoshta edhe MEF do të jetë e arsyeshëm në rishqyrtimin e një kërkesë të serishme, dhe ky debat të mbyllet...

Valdete Daka: Aq më tepër që, në plan kemi të paraparë edhe raundin e dytë – balotazhin !

Čemailj Kurtiši: Kisha thënë edhe unë që mos të jemi në qendër të vëmendjes, mendoj që duhet t'i ikim kësaj por një lloj mirëkuptimi...! Kisha dashur vetëm t'i shtroj disa pyetje: për shembull, a është kjo konform ligjit, nëse është konform ligjit, me ligj është, absolutisht... Asnjëherë nuk kisha dashur të ta fus dorën në xhepin e huaj! Në xhepin e qytetarëve, të taksapaguesve por nëse është me ligj...? Unë, deri sa kam qenë nënkryetar në komunën e Prizrenit, e di që kam pasur problem me vozitësit që kanë punuar ndoshta më shumë se 100 orë tepër, por nuk janë paguar mirëpo, gjithmonë ka rrugëdalje...Por, nuk dëshiroj të kemi konflikt me qeverinë, dhe s'kemi arsye që të konfrontohemi dhe të jemi në shënjestër të mediave...

Në këtë pikë, debatuan më tej: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Alim Rama, Yll Buleshkaj, Valdete Daka, Ibrahim Selmanaj dhe Arianit Elshani. I gjithë diskutimi, u fokusua mbi vlerësime, analiza, krahasime etj., në mënyrë që të përpilohet një kërkesë sa më e arsyeshme, dhe e bazuar në ligj në mënyrë që, të mos krijohet asesi konflikt me qeverinë por, vetëm të ndiqet rruga e arsyeshme ligjore.

Valdete Daka: Gjithsesi, s'kemi çka të diskutojmë por, jemi të shqetësuar sepse jem bërë temë...Ndërkaq, me korrektimet, sugjerimet tona, unë po e hedh në votim këtë plan ! Kush është për ?

Me shtatë vota për, dhe tri abstenime aprovohet Kërkesa Buxhetore për Kompensim të orëve shtesë për anëtarët e KQZ-së, dhe stafin e SKQZ-së.

4.Të ndryshme.